

WB GOLD - ProCredit Kosovë

Shteti:	KOSOVË
Projekti Nr.:	56413
Sektori i biznesit:	Kredi depozitare (banka)
Lloji i Njoftimit:	PRIVAT
Kategoria Mjedisore:	
Data e Synuar e Aprovimit:	29 maj 2025
Statusi:	Në eksplorim
DPP i shpalosur:	29 prill 2025

Përshkrimi i Projektit

Një hua senior e pasiguruar deri në 10 milionë EURO që do t'i ofrohet ProCredit Bank në Kosovë (PCBK) në dy këste të barabarta në kuadër të Kornizës për Financim të Borxhit të Lidhur me Rezultate të Gjelbra për Ballkanin Perëndimor (WB GOLD).

Objektivat e Projektit

Të ardhurat e huasë do të përdoren për ofrimin e nën-huave për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) dhe Midcaps (ndërmarrje me kapitalizim të mesëm) të pranueshme në Kosovë për mbështetjen e zgjerimit të bizneseve të tyre dhe investimeve të pranueshme për Tranzicionin e Ekonomisë së Gjelbër (GET). Të paktën 50% e investimeve të përgjithshme do të jenë të pranueshme për GET.

Ndikimi i Tranzicionit

Projekti kontribuon në objektivat e WB GOLD, duke mbështetur kualitetet Konkurrues dhe i Gjellbër të tranzicionit. WB GOLD synon të nxisë konkurrueshmërinë e NVM-ve duke (i) rritur disponueshmërinë e financimit; dhe (ii) inkurajuar inovacionin në strategji, produkte dhe procese. Veç kësaj, projekti do të inkurajojë kualitetin e gjelbër duke rritur shkallën e investimeve në teknologjitë e pranueshme për GET nga NVM-të dhe ndërmarrjet me kapitalizim të mesëm, dhe duke kontribuar kështu në ndërtimin e një ekonomie me karbon të ulët dhe reziliente ndaj klimës.

Informata për Klientin

PROCREDIT BANK SH.A. KOSOVË

ProCredit Bank në Kosovë ("PCBK"), degë e ProCredit Holding, është banka e tretë më e madhe komerciale në Kosovë për sa i përket kredive neto, me pjesë të tregut prej 15.3%, dhe banka e katërt më e madhe për sa i përket totalit të aseteve, me pjesë të tregut prej 15% prej VF 2024. PCBK ofron një gamë gjithëpërfshirëse të produkteve për individë privatë, NVM dhe korporata. Klienti është një IFP i rëndësishëm dhe i kahershëm i BERZH-it marrë parasysh performancën e vet të fortë financiare, fokusin në huadhënien e orientuar drejt zhvillimit dhe me përgjegjësi mjedisore, si dhe ekskluzivitetin e krijuar në segmentin e NVM-ve.

Përmbledhja e Financimit të BERZH-it

10,000,000.00 EURO

Gjithsej Kosto të Projektit

10,000,000.00 EURO

Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

I kategorizuar FI (ESP 2014). PCBK është klient ekzistues që demonstroi performancë të kënaqshme mjedisore dhe sociale (MS) sipas ekspozimit të vet aktual përmes Raportit të vet Vjetor Mjedisor dhe Social për vitin 2023. Të ardhurat do të përdoren në kuadër të Kornizës për Financim WB GOLD për të financuar nën-huamarrës të pranueshëm në Kosovë, me nënprojektet e pranueshme që konsiderohen me risk të ulët nga këndvështrimi Mjedisor dhe Social. PCBK, si klient i kahershëm i BERZH-it, është i detyruar të zbatojë Politikën dhe Procedurat për Menaxhim Mjedisor dhe Social, të cilat përputhen me kërkesat për MS të BERZH-it. PCBK merr pjesë në Kompaktin Global të OKB-së, duke reflektuar angazhimin e vet ndaj praktikave të përgjegjshme të biznesit. Është gjithashtu i certifikuar sipas ISO 14001:2015 për Sistemin e Menaxhimit Mjedisor, duke demonstruar një qasje të strukturuar ndaj qëndrueshmërisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm. Vitin e kaluar, PCBK u bë institucioni i parë në Kosovë që mori Certifikimin e Ekselencës në Dizajn për Eficiencë më të Madha, duke demonstruar performancë të avancuar mjedisore. Nga PCBK pritet ta mirëmbajë sistemin e vet për menaxhim Mjedisor dhe Social, t'i vlerësojë, menaxhojë dhe monitorojë në mënyrë efektive risqet dhe ndikimet Mjedisore dhe Sociale që lidhen me nënprojektet e veta. Duhet ta përafrojë qasjen e vet me udhëzimet e BERZH-it për financimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe të jetë në pajtueshmëri me Kërkesat Mjedisore dhe Sociale (KMS) 2, 4 dhe 9 të BERZH-it sipas PMS-së 2024, duke përfshirë listën e përjashtimeve. Gjithashtu, duhet të vazhdojë t'i dorëzojë Bankës Raportet Vjetore Mjedisore dhe Sociale, duke detajuar pajtueshmërinë me KMS-të përkatëse dhe duke adresuar çdo çështje MS që lind gjatë vitit. Nën-huamarrësit e financuar nëpërmjet PCBK-së duhet të jenë në pajtueshmëri me rregulloret kombëtare për mjedisin, shëndetin, sigurinë dhe punën. Nëse financimi i BERZH-it përdoret për të financuar nënprojekte për energji të ripërtërishme, këto nënprojekte duhet të përmbushin kriteret e pranueshmërisë Mjedisore dhe Shoqërore të BERZH-it për nënprojektet për energji të ripërtërishme dhe kriteret e tjera të pranueshmërisë të përcaktuara në Deklaratën e Politikave të BERZH-it.

Bashkëpunimi Teknik

Projekti do të mbështetet nga një reduktim kuazi-margjinal të financuar nga donatorët, në formën e një Kompensimi të Bazuar në Rezultate (KBR) deri në 150,000 EURO, dhe një paketë të

Bashkëpunimit Teknik (BT) që synon (i) të mbështesë raportimin dhe verifikimin e realizimit të pjesës së GET; dhe (ii) të ndihmojë PCBK-në dhe nën-huamarrësit me vlerësimin e nënprojekteve komplekse ose të mëdha të pranueshme për GET, për të cilat përfituesve mund t'u mungojnë shkathtësitë dhe njohuritë teknike. KBR-ja dhe faza fillestare e BT-së financohet nga Fondi i Posaçëm i Aksionarëve të BERZH-it (SSF).

Shtueshmëria

BERZH-i ofron një instrument inovativ për financim të gjelbër i cili sjell stimuj të bazuar në rezultate për të stimuluar sektorin financiar për të rritur financimin e gjelbër për NVM-të dhe ndërmarrjet me kapitalizim të mesëm në një mënyrë të institucionalizuar, duke mbështetur nevojat e përgjithshme të financimit të NVM-ve. Veç kësaj, BERZH-i ofron financim afatmesëm që është mbi mesataren e tregut dhe ofron ekspertizë, inovacion, njohuri dhe/ose kapacitete me rëndësi vendimtare për realizimin në kohë të objektivave të projektit.

Informatat e Kontaktit të Kompanisë

Albulena Mustafa-Zatriqi
Albulena.Mustafa@procredit-group.com
 +383 49 555 869
 Rr. George Bush Nr. 26, 10000 Prishtinë Kosovë

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni [Prokurimet e BERZH](#):

Tel: +44 20 7338 6794

Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS](#) dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS dhe PR përfshijnë

dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikën e BERZH në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime për praktikën mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke [përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH](#).

Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimit në nivel projektit të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH.

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikën e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikën mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me [Politikën Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat

specifike për Projektin të [Politikës së Qasjes në Informacion](#); dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për [Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit](#) për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të [dërguar një kërkesë](#) për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit ipam@ebrd.com për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.